



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Nr. 2349 Prot.

Patos, më 17.07.2026

MIRATOI
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 45, datë 17.07.2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN E
TURIZMIT PËR VITET 2026-2031

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar dhe urdhrit nr. 117, datë 15.05.2026, Bashkia Patos ka hartuar dhe paraqet për miratim Planin Lokal të Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit për vitet 2026 - 2031.

Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e Planit Lokal të Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit për vitet 2026 - 2031 sipas shtojcës 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

Bashkëlidhur relacioni shpjegues.

Juela Shpata

Blerina Laçi

Grupi i punës

Mitjon Nikolla

Albora Sulaj

Eneo Xhaferri

Donald Xhafa

Juriste

Joana Sherifi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Nr. 2348/Prot.

Patos, më 17.07.2026

RELACION
PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN E
TURIZMIT PËR VITET 2026 - 2031

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në zbatim të detyrimeve ligjore në fushën e turizmit, Bashkia Patos ka hartuar Planin Lokal të Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit për vitet 2026 - 2031, i cili kaloi edhe në konsultim publik me grupet e interesit në datën 21.07.2026.

Ky dokument përbën një instrument të rëndësishëm planifikimi vendor, i cili synon ta pozicionojë turizmin, në funksion të diversifikimit ekonomik, promovimit të kapitalit natyror dhe kulturor, forcimit të identitetit lokal dhe rritjes së përfitimeve për komunitetin. Deri në vitin 2031, Bashkia Patos do të njihet si një destinacion lokal autentik i Qarkut Fier, që ofron përvoja të integruara në natyrë, kulturë, agroturizëm dhe trashëgimi industriale, duke krijuar përfitime të prekshme për komunitetin, duke ruajtur kapitalin natyror dhe duke forcuar identitetin vendor.

Hartimi i këtij plani mbështetet në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar.

Në përmbajtje të planit janë analizuar faktorët kryesorë që ndikojnë në elemente të trashëgimisë kulturore, monumente kulti, peizazhe natyrore dhe burime ujore, si dhe elemente të trashëgimisë industriale që lidhen me historinë e naftës. Potenciali turistik i tyre qëndron jo vetëm te prania fizike, por edhe te aftësia për t'u interpretuar, lidhur në itinerare dhe menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme.

Për periudhën 2026 - 2031 rekomandohet që në fazën e parë të zhvillimit të përzgjidhen disa asete prioritare, ku ndërhyrjet për interpretim, sinjalistikë dhe promovim do të prodhonin efekt më të shpejtë: Kalaja e Margëlliçit si pikë identitare historike; rezervuari i Zharrëzës dhe ujëvarat e Siqecës si destinacione natyrore; Manastiri i Shën Trifonit dhe Mekami i Drenies si asete me peshë simbolike e komunitare; si dhe disa ferma/ullishte/sera të përzgjedhura si bazë për përvoja agroturistike. Përzgjedhja graduale e aseteve është e rëndësishme për të shmangur shpërndarjen e burimeve dhe për të ndërtuar një produkt të fokusuar, të besueshëm dhe të menaxhueshëm.

Promovimi i Patosit si destinacion kërkon ndërtimin e një narrative të qartë dhe të dallueshme. Brendi i destinacionit duhet të mbështetet në identitetin e shumëfishtë të territorit: natyrë, histori, bujqësi dhe industri. Për këtë arsye rekomandohet krijimi i një

profili të unifikuar komunikimi, me materiale vizuale, përmbajtje digjitale, hartë të aseteve, kalendar eventesh dhe histori të shkurtra interpretuese që mund të përdoren në rrjete sociale, në faqet zyrtare dhe në platformat kombëtare të promovimit.

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Patos miratimin e Planit Lokal të Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit për vitet 2026 - 2031.

Grupi i punës

Juela Shpata



Mitjon Nikolla

Eneo Xhaferri

Joana Sherifi

Blerina Laçi



Albora Sulaj



Donald Xhafa



ZV.KRYETARE

Ina Sauli





**PLANI LOKAL I STRATEGJISË PËR
ZHVILLIMIN E TURIZMIT PËR VITET
2026-2031**



Përmbajtja	
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. HYRJE DHE KONTEKSTI I PLANIT	4
2. METODOLOGJIA DHE BURIMET	4
3. PROFILI TERRITORIAL DHE SOCIO -EKONOMIK I BASHKISË PATOS	5
4. KAPITALI NATYROR DHE ASETET ME POTENCIAL TURISTIK	6
5. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE TË TURIZMIT	7
6. ANALIZA SWOT DHE PROBLEMATIKAT KYÇE	9
7. VIZIONI 2031, PARIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË.....	10
8. PRIORITETET STRATEGJIKE DHE PROGRAMET E NDËRHJRJES	10
9. PORTOFOLI I PRODUKTEVE TURISTIKE DHE PAKETAT TEMATIKE	11
10. MARKETINGU TERRITORIAL DHE PROMOVIMI DIGJITAL	12
KALENDARI ORIENTUES I EVENTEVE TURISTIKE VENDORE	13
11. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE DHE PARTNERITETET LOKALE.....	13
12. PLANI I VEPRIMIT 2026 - 2031	14
13. ZBATIMI DHE FINANCIMI	19
14. MONITORIMI DHE VLERËSIMI.....	19
15. ANEKSA DHE BURIME	20
Foto të aseteve.....	21

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani Lokal për Zhvillimin e Turizmit i Bashkisë Patos për periudhën 2026 - 2031 paraqet kuadrin strategjik dhe programin e ndërhyrjeve prioritare për zhvillimin gradual dhe të qëndrueshëm të turizmit në territorin e bashkisë. Dokumenti synon ta pozicionojë turizmin si një instrument plotësues të zhvillimit vendor, në funksion të diversifikimit ekonomik, valorizimit të kapitalit natyror dhe kulturor, forcimit të identitetit lokal dhe rritjes së përfitimeve për komunitetin.

Një bazë themelore e këtij plani është qasja e menaxhimit të kapitalit natyror, e dokumentuar në Raportin e Vlerësimit të Kapitalit Natyror për Bashkinë Patos (2024). Ky raport evidenton praninë e burimeve minerare, ujore, pyjore, bujqësore dhe të biodiversitetit, si dhe potencialin e tyre për përdorime alternative që kontribuojnë në mirëqenien lokale. Në këtë kuadër, plani e trajton turizmin si një sektor ndërthurës, i cili lidhet me mjedisin, kulturën, bujqësinë, edukimin dhe promovimin territorial.

Dokumenti është ndërtuar mbi një logjikë të konsoliduar të planifikimit vendor të turizmit, e cila përfshin analizën e situatës aktuale, identifikimin e potencialeve dhe problematikave, formulimin e vizionit dhe objektivave strategjikë, përcaktimin e prioriteteve të ndërhyrjes dhe strukturimin e planit të veprimit. Në këtë kuptim, plani orienton ndërhyrjet në drejtim të zhvillimit të produkteve turistike lokale dhe autentike, përmirësimit të infrastrukturës së butë, rritjes së kapaciteteve vendore, promovimit digjital dhe forcimit të partneriteteve lokale e rajonale.

Prioritetet strategjike 2026 - 2031 janë të përmbledhura si vijon:

- Krijimi i një portofoli produktesh turistike të integruara (natyrë - kulturë - agro - industrial).
- Zhvillimi i infrastrukturës së butë turistike dhe shërbimeve mbështetëse në pikat kyçe.
- Ruajtja/rehabilitimi i aseteve natyrore e kulturore dhe menaxhimi i riskut mjedisor.
- Ngritja e kapaciteteve lokale dhe formalizimi i ofertës së mikpritjes (bujtina, guida, artizanat).
- Promovimi digjital, brendimi i destinacionit dhe kalendari i eventeve gjithëvjetore.
- Qeverisja e turizmit: koordinim ndërsektorial, partneritete, monitorim me indikatorë.

Zbatimi parashikohet përmes një programi masash dhe projektsh të ndara në tre faza (2026 - 2027, 2028 - 2029, 2030 - 2031), me përgjegjësi të qarta institucionale dhe me indikatorë monitorimi. Plani rekomandon raportim vjetor të progresit, rishikim të ndërmjetëm në vitin 2028 dhe përditësim në përfundim të periudhës, duke ruajtur fleksibilitet për t'u përshtatur me ndryshimet në tregun turistik, zhvillimet mjedisore dhe prioritetet financiare.

1. HYRJE DHE KONTEKSTI I PLANIT

Bashkia Patos po hyn në një fazë të re të planifikimit vendor, ku turizmi shihet jo si sektor i izoluar, por si instrument për diversifikimin ekonomik, rigjallërimin e hapësirave urbane e rurale, valorizimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe forcimin e identitetit lokal. Ky plan hartohet për periudhën 2026 - 2031 në një moment kur territori përballlet me nevojën për të gjetur ekuilibër ndërmjet përdorimeve tradicionale ekonomike - veçanërisht bujqësisë dhe industrisë së naftës - dhe formave të reja të zhvillimit të qëndrueshëm që krijojnë vlerë të shtuar për komunitetin.

Territori i Bashkisë Patos ka një pozicion të favorshëm në Qarkun Fier, në afërsi të korridoreve kryesore lidhëse me Fierin, Roskovecin, Mallakastrën dhe zonat bregdetare. Ky pozicion, i kombinuar me praninë e aseteve natyrore, monumenteve kulturore dhe peizazheve rurale, krijon kushtet për zhvillimin e një oferte turistike gjithëvjetoje, me fokus në turizmin e natyrës, agroturizmin, turizmin kulturor dhe turizmin e trashëgimisë industriale. Planit nuk synon masivizimin e turizmit, por ndërtimin gradual të një destinacioni lokal me identitet të qartë dhe me ndikim pozitiv ekonomik, social dhe mjedisor.

Qëllimi i planit është të orientojë institucionet vendore, njësitë administrative, bizneset dhe partnerët drejt një kuadri të përbashkët veprimi për turizmin 2026 - 2031. Në këtë kuptim, plani përcakton vizionin, objektivat, prioritetet strategjike, programet e ndërhyrjes dhe mekanizmat e monitorimit, duke ofruar një bazë praktike për koordinimin ndërsektorial dhe për integrimin e turizmit në politikat e zhvillimit vendor, të mjedisit, kulturës, bujqësisë, rinisë dhe infrastrukturës.

2. METODOLOGJIA DHE BURIMET

Hartimi i këtij plani është mbështetur në kombinimin e analizës dokumentare, interpretimit të të dhënave ekzistuese dhe përshtatjes së praktikave të mira të planifikimit vendor të turizmit. Si burim themelor është përdorur Raporti i Vlerësimit të Kapitalit Natyror për Bashkinë Patos (2024), i cili ofron inventarin sasior dhe cilësor të burimeve natyrore, një pasqyrë të strukturës ekonomike vendore dhe një lexim të potencialeve të territorit për përdorime alternative, përfshirë turizmin. Paralelisht, si referencë metodologjike është përdorur struktura e një strategjie lokale të turizmit të hartuar për një bashki tjetër të Qarkut Fier, me fokus në logjikën e analizës së situatës, SWOT-it, prioritetëve strategjike dhe planit të veprimit.

Metodologjia e ndjekur në këtë plan përfshin: (i) leximin e profilin territorial të Bashkisë Patos; (ii) identifikimin e aseteve natyrore, kulturore dhe ekonomike me potencialistik; (iii) vlerësimin e gjendjes aktuale të ofertës turistike, infrastrukturës dhe kapaciteteve organizative; (iv) formulimin e vizionit dhe objektivave strategjike për periudhën 2026 - 2031; dhe (v) strukturimin e masave të veprimit, indikatorëve të monitorimit dhe mekanizmave të zbatimit. Ky plan është konceptuar si dokument dinamik, i hapur për përditësim periodik në varësi të ndryshimeve në treg, në mjedis dhe në prioritetet e investimeve vendore.

3. PROFILI TERRITORIAL DHE SOCIO -EKONOMIK I BASHKISË PATOS

Bashkia Patos është pjesë e Qarkut Fier dhe përbëhet nga tre njësi administrative: Patos, Zharrëz dhe Ruzhdië. Territori shtrihet në një hapësirë me karakter të kombinuar fushor dhe kodrinor, në zonën ndërmjet fushës së Myzeqesë dhe luginës së lumit Gjanica, me lidhje të afërta me qytetin e Fierit dhe me korridoret rajonale të lëvizjes. Ky pozicion e favorizon bashkinë si pikë ndalese dhe si destinacion ditor/fundjave, veçanërisht nëse oferta lokale lidhet në mënyrë inteligjente me destinacionet e konsoliduara të qarkut dhe rajonit.

Struktura ekonomike e Bashkisë Patos dominohet nga industria e nxjerrjes së naftës, bujqësia, blegtoria dhe aktivitetet e lidhura me shërbimet vendore. Nga njëra anë, territori mbart peshën historike dhe ekonomike të vendburimit Patos - Marinëz, një nga asetet më të mëdha minerare në vend; nga ana tjetër, ka një traditë të fortë bujqësore, me toka pjellore, prodhim perimesh, sera, pemëtari, ullishte dhe blegtori. Kjo dysi - industri e rëndë dhe prodhim rural - e bën Patosin një territor të veçantë, ku turizmi mund të luajë rol ndërmjetësues për të krijuar përvoja autentike, edukative dhe me vlerë identitare.

Bashkia disponon gjithashtu kapital njerëzor dhe social me vlerë për zhvillimin turistik. Komuniteti ruan tradita lokale, festa vendore, rrëfime historike dhe lidhje të forta me territorin, ndërsa ekzistenca e personelit teknik dhe administrativ me përvojë në bujqësi, mjedis dhe menaxhim vendor krijon një bazë të mirë për organizimin e produkteve turistike. Festat e qytetit dhe festat e njësisë administrative, si dhe nismat me karakter kulturor e komunitar, mund të shndërrohen në elementë të rëndësishëm të kalendarit turistik lokal.

3.1 Njësitë administrative dhe karakteri i tyre territorial.

Njësia administrative Patos përfaqëson qendrën urbane dhe administrative të bashkisë, me densitet më të lartë aktiviteti ekonomik dhe me identitet të lidhur fort me industrinë e naftës. Zharrëza ka një profil më të theksuar rural dhe agro - prodhues, por në të njëjtën kohë mbart elemente me rëndësi historike, fetare dhe natyrore, si rezervuari, Novosela dhe Sheqishtëja. Ruzhdië karakterizohet nga një peizazh më kodrinor dhe nga prania e aseteve natyrore e kulturore si ujëvarat e Siqecës, rezervuari i Ruzhdiës, Mekami i Drenies dhe Varri i Baba Mustafait. Kjo larmi territoriale i jep Bashkisë Patos mundësinë për të ndërtuar një destinacion me profile të ndryshme brenda të njëjtit kuadër vendor.

3.2 Popullsia, puna dhe sfidat sociale.

Struktura e popullsisë dhe e punësimit në Bashkinë Patos tregon një territor me potencial të rëndësishëm njerëzor, por edhe me sfida tipike të zonave që janë përballur me transformime ekonomike. Sektori i bujqësisë vazhdon të jetë një nga burimet kryesore të të ardhurave për shumë familje, ndërsa industria e naftës ka lënë gjurmë të forta në kulturën e punës dhe në identitetin lokal. Në të njëjtën kohë, emigrimi, lëvizja e të rinjve drejt qendrave më të mëdha urbane dhe ulja e interesit për sektorët tradicionalë krijojnë nevojën për forma të reja aktivizimi ekonomik. Turizmi

mund të kontribuojë në këtë drejtim duke hapur mundësi për vetëpunësim, mikrondërmarrje, organizim eventesh, artizanat, guida lokale dhe shërbime me bazë komunitare.

3.3 Identiteti vendor dhe narrativa e destinacionit.

Një nga elementet që e bëjnë Patosin të veçantë është ndërthurja e identiteteve të ndryshme: qyteti i naftëtarëve, peizazhi rural i Myzeqesë, memoria historike ilire dhe antike, si dhe prania e monumenteve të kultit dhe e vendeve të shenjta me peshë për komunitetin. Kjo shumësi narratives mund të përkthehet në një avantazh konkurrues, pasi i lejon destinacionit të mos mbështetet vetëm në një tipologji turistike. Në vend të një imazhi të vetëm, Patosi mund të pozicionohet si një destinacion me shtresa: një vend që ofron rrëfim historik, peizazh natyror, mikpritje rurale dhe kujtesë industriale në të njëjtën kohë.

4. KAPITALI NATYROR DHE ASETET ME POTENCIAL TURISTIK

Patosi disponon një mozaik asetesh që mund të strukturohen në një ofertë turistike të larmishme. Këto asete përfshijnë elemente të trashëgimisë kulturore, monumente kulturi, peizazhe natyrore dhe burime ujore, si dhe elemente të trashëgimisë industriale që lidhen me historinë e naftës. Potenciali turistik i tyre qëndron jo vetëm te prania fizike, por edhe te aftësia për t'u interpretuar, lidhur në itinerare dhe menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme.

4.1 Asetet kulturore dhe historike.

Bashkia Patos ka një trashëgimi të pasur arkeologjike, historike dhe fetare. Ndër asetet më të rëndësishme spikat Kalaja e Margëlliçit, një monument me vlera antike dhe me rëndësi në sistemin e fortifikimeve historike të zonës. Tuma e Patosit, me shtresëzime të hershme ilire, përfaqëson një aset arkeologjik me vlerë të lartë edukative. Në të njëjtën linjë, Ura e Ofiçinës lidhet me historinë e shfrytëzimit të pasurive nëntokësore dhe mund të integrohet në narrativën e turizmit industrial. Po ashtu, gjurmët e vendbanimeve të vjetra në Novoselë dhe në zonat përreth forcojnë potencialin për itinerare historike dhe edukative.

Monumentet e kultit përbëjnë një tjetër shtyllë të ofertës së mundshme turistike: Kisha e Shën Mëhillit në Dukas Breg, Manastiri i Shën Trifonit në Sheqishte, Mekami i Drenies dhe Varri i Baba Mustafait në Ruzhdie janë asete që mund të përfshihen në itinerare të turizmit kulturor, shpirtëror dhe komunitar. Këto vende mbartin jo vetëm vlera historike dhe fetare, por edhe rrëfime, legjenda dhe zakone që pasurojnë përvojën e vizitorit. Ruajtja dhe interpretimi i tyre kërkon një qasje të kujdesshme, me respekt për funksionin fetar dhe simbolik që ato kanë për komunitetin lokal.

4.2 Asetet natyrore dhe peizazhore.

Ndër asetet kryesore natyrore të Bashkisë Patos përmenden lumi Seman, rezervuari i Zharrëzës, rezervuari i Ruzhdies, ujëvarat në kanionin e Siqecës dhe masivet pyjore të Drenie - Gjinoqarës, Kasnicës dhe zonës së Zharrëzës. Rezervuarët, përveç rolit të tyre në ujtje, kanë potencial për aktivitete rekreative, vëzhgim natyre dhe edukim mjedisor. Ujëvarat e Siqecës ofrojnë peizazh të

veçantë, terren për ecje në natyrë dhe mundësi për krijimin e një produkti ekoturistik me profil lokal. Pyjet dhe shkurret, së bashku me zonat kodrinore, mund të mbështesin zhvillimin e shtigjeve, pikave panoramike dhe aktiviteteve të lehta në natyrë.

4.3 Peizazhi rural dhe bujqësia si atraksion.

Tokat bujqësore të bashkisë, prodhimi i perimeve, frutave, ullirit, rrushit dhe aktivitetet e serave krijojnë një bazë shumë të fortë për zhvillimin e agroturizmit. Fshatrat e njësive administrative, ullishtet, fermat dhe praktikat e prodhimit bujqësor mund të strukturohen në përvoja për vizitorë: vizita në ferma, degustime produktesh, aktivitete sezonale, panaire të prodhimit lokal dhe evente tematike të lidhura me gastronominë. Ky potencial është veçanërisht i rëndësishëm sepse lidh drejtpërdrejt turizmin me ekonominë reale të familjeve vendore.

4.4 Trashëgimia industriale dhe identiteti i naftës.

Patosi ka një identitet të veçantë si qytet i lidhur historikisht me industrinë e naftës. Edhe pse përdorimi turistik i kësaj trashëgimie kërkon kujdes të madh për çështjet e sigurisë dhe mjedisit, narrativi i “qytetit të naftëtarëve”, infrastruktura historike industriale dhe lidhja e komunitetit me këtë sektor përbëjnë bazë për një produkt interpretativ dhe edukativ unik në nivel vendor. Ky dimension e dallon Patosin nga destinacione të tjera rurale dhe mund të përdoret në brendimin e tij si destinacion me identitet të shumëfishtë: natyrë, histori, bujqësi dhe industri.

4.5 Asetet prioritare për interpretim turistik.

Për periudhën 2026 - 2031 rekomandohet që në fazën e parë të zhvillimit të përzgjidhen disa asete prioritare, ku ndërhyrjet për interpretim, sinjalistikë dhe promovim do të prodhonin efekt më të shpejtë: Kalaja e Margëlliçit si pikë identitare historike; rezervuari i Zharrëzës dhe ujëvarat e Siqecës si destinacione natyrore; Manastiri i Shën Trifonit dhe Mekami i Drenies si asete me peshë simbolike e komunitare; si dhe disa ferma/ullishte/sera të përzgjedhura si bazë për përvoja agroturistike. Përzgjedhja graduale e aseteve është e rëndësishme për të shmangur shpërndarjen e burimeve dhe për të ndërtuar një produkt të fokusuar, të besueshëm dhe të menaxhueshëm.

5. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE TË TURIZMIT

Aktualisht, turizmi në Bashkinë Patos ndodhet në një fazë fillestare, me mungesë të një oferte të konsoliduar dhe të strukturuar. Ndërsa territori ka asete të shumta, ato nuk janë ende të lidhura në produkte të qarta, të paketueshme dhe të promovueshme si destinacion i mirëfilltë. Kjo situatë bën që potenciali ekzistues të mbetet kryesisht latent, ndërsa vizitat të zhvillohen në mënyrë sporadike, të pakoordinuar dhe pa ndikim të qëndrueshëm në ekonominë vendore.

Mungesat më të dukshme lidhen me infrastrukturën e butë turistike dhe shërbimet mbështetëse: sinjalistika orientuese është e kufizuar, mungojnë pika informacioni, nuk ka itinerare të standardizuara të vizitës, nuk ka qendra interpretative dhe prania digjitale e destinacionit është ende e dobët. Po ashtu, oferta e akomodimit është e kufizuar dhe jo e pozicionuar mjaftueshëm në rrjetet formale të promovimit. Këto boshllëqe ulin kohëzgjatjen e qëndrimit, vështirësojnë

orientimin e vizitorëve dhe kufizojnë shndërrimin e aseteve në të ardhura konkrete për komunitetin.

Një sfidë tjetër lidhet me kapacitetet organizative dhe qeverisjen e turizmit në nivel vendor. Në territor mungon ende një rrjet i konsoliduar aktorësh turistikë lokalë - guida, mikpritës, operatorë aktivitetesh, artizanë, prodhues lokalë - të cilët të veprojnë në mënyrë të koordinuar. Gjithashtu, menaxhimi i aseteve me potencial turistik kërkon një bashkërendim më të fortë ndërmjet sektorëve të mjedisit, kulturës, bujqësisë, infrastrukturës dhe promovimit, në mënyrë që ndërhyrjet të jenë të lidhura dhe të kenë ndikim afatgjatë.

5.1 Oferta turistike ekzistuese.

Në gjendjen aktuale, oferta turistike e Bashkisë Patos nuk është e konsoliduar në formën e produkteve të strukturuar. Vizitat realizohen më shumë si lëvizje spontane të banorëve vendas, si ndalesa të rastësishme apo si interes individual për vende të caktuara. Mungojnë paketa të gatshme që të lidhin disa pika në një eksperiencë të vetme, mungon ritmi i eventeve me profil turistik dhe mungojnë mekanizmat për të transformuar vizitën në konsum lokal. Kjo do të thotë se sfida nuk është vetëm të rritet numri i vizitorëve, por edhe të ndërtohet një “arsye qëndrimi” dhe një “arsye konsumimi” brenda territorit.

5.2 Infrastruktura dhe aksesueshmëria.

Territori i bashkisë ka avantazhin e aksesit relativisht të mirë rrugor me qytetin e Fierit dhe me akset rajonale, por kjo nuk mjafton për një përvojë turistike cilësore. Aksesueshmëria turistike nuk lidhet vetëm me rrugën automobilistike, por edhe me orientimin në terren, cilësinë e pikave të ndalimit, mundësinë e ecjes, sigurinë, sinjalistikën dhe lehtësinë për të gjetur informacion. Në Patos mungojnë një numër elementësh që do ta bënin destinacionin më të lexueshëm për vizitorin: tabela hyrëse, tabela interpretuese, itinerare të shënuara, pika të vogla pushimi, hapësira për foto, materiale informuese dhe një pikë orientimi qendror.

5.3 Shërbimet, mikpritja dhe përvoja e vizitorit.

Përvoja turistike nuk përkufizohet vetëm nga bukuria e aseteve, por edhe nga mënyra si vizitori pritët, orientohet dhe shërbehet. Në Patos, kjo hallkë është ende në zhvillim. Oferta e mikpritjes rurale, e guidave, e degustimeve, e artizanatit dhe e aktiviteteve të lehta të kohës së lirë është e kufizuar dhe kryesisht jo e organizuar. Për këtë arsye, një nga ndërhyrjet më të rëndësishme duhet të jetë ndërtimi i një “ekosistemi mikpritjeje”, ku njerëzit lokalë të ndihen pjesë aktive e turizmit dhe ku vizitori të mund të gjejë jo vetëm një vend për të parë, por edhe një arsye për të qëndruar, konsumuar dhe për t’u kthyer.

5.4 Mjedisi, siguria dhe qëndrueshmëria.

Duke qenë se kapitali natyror është një nga bazat e zhvillimit të propozuar turistik, gjendja mjedisore e territorit mbetet çështje qendrore. Prania e industrisë së naftës, presionet mbi burimet ujore, problematikat e ndotjes dhe mungesa e mirëmbajtjes në disa zona të natyrës nënkuptojnë se turizmi nuk mund të zhvillohet pa masa shoqëruese të kujdesit mjedisor. Kjo do të thotë se çdo ndërhyrje turistike duhet të shoqërohet me pastrim, menaxhim të mbetjeve, informim për sjelljen

e vizitorit, mirëmbajtje të vazhdueshme dhe shmangie të përdorimeve që cenojnë ekuilibrin e zonave të ndjeshme.

6. ANALIZA SWOT DHE PROBLEMATIKAT KYÇE

Forcat: Identitet lokal i dallueshëm; prani e aseteve natyrore, kulturore, rurale dhe industriale; pozicion i favorshëm gjeografik në Qarkun Fier; traditë bujqësore dhe prodhim lokal cilësor; komunitet me lidhje të forta me territorin.

Dobësitë: Mungesë e ofertës së strukturuar turistike; sinjalistikë dhe interpretim të pamjaftueshëm; akomodim i kufizuar dhe joformal; koordinim i dobët ndërsektorial; prani e dobët digjitale dhe promovuese.

Mundësitë: Rritja e kërkesës për destinacione autentike, rurale dhe afër natyrës; lidhja me qarkullimet ekzistuese rajonale; integrimi i turizmit me bujqësinë, gastronominë dhe edukimin mjedisor; zhvillimi i itinerareve tematike dhe eventeve gjithëvjeto, zhvillimi rural dhe shfrytëzimi si potencial turistik.

Kërcënimet: Degradimi mjedisor, ndotja dhe presionet mbi burimet ujore; konkurrenca nga destinacione më të konsoliduara; shpopullimi i zonave rurale dhe emigrimi i të rinjve; mungesa e investimeve të qëndrueshme në mirëmbajtje dhe interpretim.

Problematikat kyçe që ky plan synon të adresojë janë: mungesa e një pozicionimi të qartë të Patosit si destinacion lokal; mungesa e lidhjes ndërmjet aseteve ekzistuese dhe përvojës së vizitorit; pamjaftueshmëria e shërbimeve turistike bazë; rreziku i mosmenaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit; dhe mungesa e përfshirjes së organizuar të komunitetit në zinxhirin e vlerës së turizmit. Këto problematika nuk mund të zgjidhen me ndërhyrje të fragmentuara, por kërkojnë një qasje të integruar dhe të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së planit.

6.1 Zgjerim i analizës SWOT.

Forca të tjera: Trashëgimi i pasur fetare dhe simbolike; mundësi për lidhje me destinacione të tjera të qarkut; peizazh rural me potencial të lartë për fotografinë dhe eventet e vogla; histori industriale unike në nivel vendor.

Dobësi të tjera: Mungesë e statistikave lokale të turizmit; mungesë e produkteve të gatshme për treg; mungesë e guidave të certifikuara; mungesë e përkthimeve dhe materialeve dygjuhëshe; mirëmbajtje e pamjaftueshme në disa asete.

Mundësi të tjera: Përdorimi i shkollave dhe të rinjve në edukimin dhe interpretimin lokal; lidhja e eventeve vendore me kalendarin turistik; zhvillimi i tureve ditore nga Fieri dhe qytetet përreth; përfshirja e komunitetit fetar dhe rural në menaxhimin e përvojës së vizitorit.

Kërcënime të tjera: Banalizimi i identitetit lokal nga ndërhyrje jo të kujdesshme; zbehja e trashëgimisë jomateriale; mungesa e vazhdimësisë administrative në zbatimin e planit; dhe rreziku që asetet të promovohen pa u përgatitur mjaftueshëm për menaxhimin e fluksit të vizitorëve.

7. VIZIONI 2031, PARIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Vizioni 2031: Deri në vitin 2031, Bashkia Patos të njihet si një destinacion lokal autentik i Qarkut Fier, që ofron përvoja të integruara në natyrë, kulturë, agroturizëm dhe trashëgimi industriale, duke krijuar përfitime të prekshme për komunitetin, duke ruajtur kapitalin natyror dhe duke forcuar identitetin vendor.

Parimet udhëheqëse të planit janë: Qëndrueshmëria mjedisore; respekti për trashëgiminë kulturore dhe simbolike; përfshirja e komunitetit; aksesueshmëria dhe mikpritja; gradualiteti i zhvillimit; bashkëpunimi ndërsektorial; dhe monitorimi i vazhdueshëm i rezultateve.

Objektivat strategjikë 2026 - 2031:

1. Të strukturohet një ofertë turistike e dallueshme dhe gjithëvjeto e Bashkisë Patos.
2. Të përmirësohet infrastruktura dhe interpretimi i aseteve turistike kryesore.
3. Të rriten kapacitetet e komunitetit dhe të bizneseve për të ofruar shërbime turistike cilësore.
4. Të forcohet imazhi dhe prania digjitale e Patosit si destinacion lokal.
5. Të garantohet ruajtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i kapitalit natyror dhe kulturor në funksion të zhvillimit turistik.

8. PRIORITETET STRATEGJIKE DHE PROGRAMET E NDËRHYRJES

Prioriteti 1 - Zhvillimi i produkteve turistike lokale dhe autentike.

Ky prioritet synon të kthejë asetet ekzistuese në përvoja konkrete për vizitorin. Fokus do të kenë itineraret tematike që lidhin natyrën, kulturën, peizazhin rural dhe trashëgiminë industriale; krijimi i paketave të vizitës ditore dhe fundjavore; si dhe integrimi i fermave, produkteve vendore dhe aktiviteteve komunitare në ofertën turistike.

Prioriteti 2 - Përmirësimi i infrastrukturës së butë turistike dhe aksesueshmërisë.

Kjo përfshin sinjalistikën orientuese dhe interpretuese, piketa dhe harta turistike, zona pushimi, shtigje ecjeje dhe biçikletash, si dhe përmirësime të vogla funksionale në pikat kyçe të vizitës. Objektivi është që asetet të bëhen të kuptueshme, të lexueshme dhe të aksesueshme për publikun.

Prioriteti 3 - Ruajtja, rehabilitimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i aseteve.

Zhvillimi i turizmit do të mbështetet vetëm nëse asetet natyrore e kulturore ruhen, pastrohen, mirëmbahen dhe interpretohen në mënyrë të përgjegjshme. Ky prioritet lidhet me ndërhyrjet minimale konservuese, menaxhimin e mbetjeve, ndërgjegjësimin mjedisor dhe rregullimin e përdorimit publik në zonat më të ndjeshme.

Prioriteti 4 - Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe formalizimi i ofertës.

Kjo nënkupton trajnimin e guidave lokale, mikpritësve, fermerëve, artizanëve dhe operatorëve të vegjël; krijimin e standardeve minimale të mikpritjes; si dhe mbështetjen për formalizimin e bujtinave, aktiviteteve agro-kulinare dhe shërbimeve të lidhura me turizmin.

Prioriteti 5 - Marketingu territorial, promovimi digjital dhe partneritetet.

Ky prioritet fokusohet në ndërtimin e identitetit të destinacionit Patos, krijimin e përmbajtjes digjitale, përdorimin e rrjeteve sociale, përfshirjen në platforma kombëtare të promovimit dhe krijimin e rrjeteve bashkëpunuese me aktorët lokalë e rajonalë.

8.1 Masa orientuese sipas prioriteteve.

Për Prioritetin 1: Përzgjedhja e aseteve prioritare; testimi i itinerareve pilot; krijimi i përshkrimeve standarde të produkteve; lidhja e fermave dhe prodhuesve lokalë me përvojat turistike.

Për Prioritetin 2: Hartëzim orientues; sinjalistikë; piketa panoramike; hapësira të vogla rekreative; shtigje tematike.

Për Prioritetin 3: Ndërhyrje të lehta konservuese; pastrim dhe mirëmbajtje; menaxhim i mbetjeve; ndërgjegjësim komunitar.

Për Prioritetin 4: Trajnime; rrjetëzim aktorësh; formalizim i shërbimeve të mikpritjes; përfshirja e të rinjve dhe grave në zinxhirin e vlerës.

Për Prioritetin 5: Identitet vizual; kanale digjitale; bashkëpunim me media; evente; integrim në itinerare rajonale.

9. PORTOFOLI I PRODUKTEVE TURISTIKE DHE PAKETAT TEMATIKE

Për të krijuar një ofertë të qartë dhe të komunikueshme, plani propozon zhvillimin e pesë linjave kryesore të produkteve turistike për Bashkinë Patos:

- 1. Rruga e Trashëgimisë Historike dhe Kulturore:** Kalaja e Margëlliçit, Tuma e Patosit, monumentet e kultit, Novosela/Sheqishte dhe rrëfimet lokale.
- 2. Rruga e Natyrës dhe Ujit:** Rezervuari i Zharrëzës, rezervuari i Ruzhdies, ujëvarat e Siqecës, bregu i Semanit dhe piketa natyrore panoramike.
- 3. Rruga e Bujqësisë dhe Shijeve Lokale:** Ferma, sera, ullishta, degustime, produkte vendore dhe evente gastronomike.
- 4. Rruga e Naftës dhe Identitetit Industrial:** Interpretim i historisë së qytetit të naftëtarëve, trashëgimisë industriale dhe lidhjes së komunitetit me industrinë.
- 5. Paketa të Eventeve dhe Festivalit Lokal:** Festa të njësive administrative, evente sezonale, panairë të prodhimit dhe aktivitete komunitare.

9.1 Rruga e Trashëgimisë Historike dhe Kulturore synon të ndërtojë një produkt me fokus edukimin, rrëfimin dhe interpretimin e historisë së territorit. Ky itinerar mund të strukturohet si vizitë ditore për nxënës, studentë, vizitorë individualë dhe grupe me interes kulturor, duke kombinuar pika me vlerë dhe arkeologjike, monumente kulti dhe vende me kujtesë historike.

9.2 Rruga e Natyrës dhe Ujit është menduar si produkt për vizitorë që kërkojnë qetësi, peizazh, kontakt me natyrën dhe lëvizje të lehtë. Rezervuarët, ujëvarat dhe pikat panoramike mund të organizohen në një sistem ndalesash që favorizon piknikun, fotografimin, ecjen dhe interpretimin e peizazhit. Ky produkt është veçanërisht i përshtatshëm për turizëm fundjave dhe për familjet.

9.3 Rruga e Bujqësisë dhe Shijeve Lokale duhet të jetë një nga produktet më të prekshme ekonomikisht, pasi lidhet direkt me aktivitetin e familjeve vendore. Përvoja të tilla si vizita në sera, degustime të vajit të ullirit, prezantime të prodhimeve vendore, gatim tradicional dhe panairë sezonale mund të gjenerojnë vlerë të shtuar dhe të krijojnë arsye reale për konsum lokal.

9.4 Rruga e Naftës dhe Identitetit Industrial përfaqëson dimensionin më dallues të Patosit. Ky produkt nuk duhet parë si turizëm klasik industrial, por si një narrativë interpretative që e shpjegon historinë e qytetit, formimin e tij, kulturën e punës dhe lidhjen e komunitetit me industrinë. Ai mund të strukturohet përmes materialeve interpretative, ekspozimeve të vogla tematike, historive njerëzore dhe ndalesave simbolike.

9.5 Paketa të Eventeve dhe Festivalit Lokal duhet të ndërtohen mbi kalendarin ekzistues vendor dhe ta zgjerojnë atë me komponent turistik. Eventet nuk duhet të jenë vetëm aktivitete festive, por instrumente për të promovuar territorin, produktet vendore dhe kulturën lokale. Në këtë kuadër, çdo njësi administrative mund të zhvillojë një profil eventesh që lidhet me identitetin e vet.

10. MARKETINGU TERRITORIAL DHE PROMOVIMI DIGJITAL

Promovimi i Patosit si destinacion kërkon ndërtimin e një narrative të qartë dhe të dallueshme. Brendi i destinacionit duhet të mbështetet në identitetin e shumëfishtë të territorit: natyrë, histori, bujqësi dhe industri. Për këtë arsye rekomandohet krijimi i një profili të unifikuar komunikimi, me materiale vizuale, përmbajtje digjitale, hartë të aseteve, kalendar eventesh dhe histori të shkurtra interpretuese që mund të përdoren në rrjete sociale, në faqet zyrtare dhe në platformat kombëtare të promovimit.

Në planin operacional, promovimi duhet të fokusohet në: Krijimin e identitetit vizual të destinacionit; dokumentimin fotografik e videografik të aseteve; hartimin e broshurave dhe materialeve interpretuese; përfshirjen në evente rajonale dhe panairë; bashkëpunimin me media lokale e kombëtare; si dhe integrimin e Patosit në itinerare rajonale të Qarkut Fier. Një rëndësi e veçantë duhet t'i jepet gjuhës së komunikimit dhe mënyrës së prezantimit të aseteve, në mënyrë që të përçohen autenticiteti, qartësia dhe mikpritja.

KALENDARI ORIENTUES I EVENTEVE TURISTIKE VENDORE

Për të rritur ritmin e vizitueshmërisë dhe për të shpërndarë atraktivitetin gjatë vitit, plani rekomandon krijimin e një kalendari orientues eventesh: pranverë - panaire të prodhimeve dhe aktivitete në natyrë; verë - evente kulturore dhe komunitare në qendrat e njësive administrative; vjeshtë - evente të lidhura me ullirin, bujqësinë dhe gastronomicën; dimër - aktivitete të vogla simbolike, promovuese dhe edukative me fokus identitetin lokal. Kalendari duhet të jetë fleksibël, por i qëndrueshëm në ritëm, në mënyrë që të krijojë pritshmëri tek publiku dhe të ndihmojë promovimin digjital të destinacionit.

11. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE DHE PARTNERITETET LOKALE

Zhvillimi i turizmit kërkon njerëz të përgatitur dhe marrëdhënie funksionale ndërmjet aktorëve lokalë. Për këtë arsye, plani rekomandon programe periodike trajnimi për guida lokale, operatorë të vegjël, mikpritës ruralë, fermerë, artizanë dhe staf bashkiak. Temat duhet të përfshijnë mikpritjen, interpretimin e trashëgimisë, organizimin e eventeve, standardet e shërbimit, komunikimin digjital dhe menaxhimin e qëndrueshëm të aseteve.

Po aq e rëndësishme është krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit ndërmjet njësive administrative, shkollave, komuniteteve fetare, grupeve rinore, fermerëve, prodhuesve lokalë dhe subjekteve private që lidhen me vizitueshmërinë. Këto partneritete duhet të shërbejnë për bashkëkrijimin e paketave turistike, për organizimin e eventeve, për menaxhimin e itinerareve dhe për rritjen e përfitimeve lokale nga turizmi.

12. PLANI I VEPRIMIT 2026 - 2031

Plani i veprimit organizon ndërhyrjet prioritare sipas logjikës: Masa - afati kohor - përgjegjësia kryesore - partnerët - treguesit e suksesit. Duke qenë se ky dokument është kërkuar pa kosto orientuese, fokusi vihet te qartësia e veprimeve, sekuenca kohore dhe rezultatet e pritshme.

Prioriteti / Masa	Veprimet kryesore	Afati	Përgjegjësia kryesore	Partnerët	Indikatorët e suksesit
PRIORITETI 1 - Zhvillimi i produkteve turistike lokale dhe autentike	Strukturimi i ofertës turistike të Bashkisë Patos në linja tematike të komunikueshme dhe të zbatueshme.	2026-2031	Bashkia Patos	Njësitë administrative, komuniteti lokal	Produkte të përcaktuara dhe të promovuara
1.1 Inventarizimi dhe klasifikimi i aseteve turistike	Hartëzim i aseteve sipas kategorive: natyrore, kulturore, agro-rurale dhe industriale; identifikim i pikave prioritare për ndërhyrje.	2026	Bashkia Patos	Ekspertë vendorë, njësitë administrative	Inventar i plotë dhe hartë asetesh
1.2 Hartimi i itinerareve tematike pilot	Krijimi i të paktën 3 itinerareve fillestare: histori-kulturë, natyrë-ujë dhe agro - shije lokale.	2026-2027	Bashkia Patos	Shkolla, fermerë, komuniteti	3 itinerare të dokumentuara dhe të prezantuara
1.3 Krijimi i paketave të vizitës ditore dhe fundjavore	Përcaktim i ndalesave, kohëzgjatjes, përmbajtjes interpretative dhe elementëve të konsumit lokal.	2027-2028	Bashkia Patos	Biznese lokale, aktorë të turizmit	Të paktën 4 paketa të gatshme për përdorim
1.4 Zhvillimi i përvojave agroturistike	Përzgjedhje fermash, ullishtesh dhe serash për vizita, degustime dhe	2027-2030	Bashkia Patos	Fermerë, prodhues vendas	Pika agroturistike të identifikuar dhe funksionale

	aktivitete sezonale.				
1.5 Krijimi i narrativës së trashëgimisë industriale	Përgatitje e materialeve interpretuese për historinë e naftës dhe identitetin e qytetit të naftëtarëve.	2027-2029	Bashkia Patos	Ish-punonjës, komuniteti lokal	Materiale interpretuese dhe përfshirje në promovim
PRIORITETI 2 – Përmirësimi i infrastrukturës së butë turistike dhe aksesueshmërisë	Krijimi i kushteve minimale fizike dhe orientuese për një përvojë turistike të lexueshme dhe të sigurt.	2026-2031	Bashkia Patos	Drejtoritë përgjegjëse, njësitë administrative	Infrastrukturë orientuese dhe e butë e përmirësuar
2.1 Sinjalistika turistike hyrëse dhe orientuese	Vendosje tabelash hyrëse në territor dhe tabelash orientuese në pikat kryesore të interesit.	2026-2028	Bashkia Patos	Njësitë administrative	Tabela të vendosura në asetet prioritare
2.2 Sinjalistikë interpretuese për asetet kryesore	Përgatitje tekstesh interpretuese për kala, monumente kulti, rezervuarë dhe ujëvara.	2027-2028	Bashkia Patos	Ekspertë lokalë, mësues, komuniteti	Pikat kryesore të pajisura me interpretim
2.3 Krijimi i shtigjeve dhe pikave të ndalimit	Shënjim dhe organizim i shtigjeve të lehta në zonat natyrore dhe kodrinore; vendosje stolash dhe pikash panoramike.	2027-2029	Bashkia Patos	Komunitetet lokale	Shtigje të aksesueshme dhe pika ndalimi
2.4 Pika orientimi / informacioni lokal	Krijimi i një forme të thjeshtë informacioni turistik në bashki ose në një aset qendror.	2028-2030	Bashkia Patos	Partnerë vendorë	Pikë funksionale orientimi për vizitorë

2.5 Harta turistike dhe materiale të terrenit	Hartim i hartave orientuese fizike dhe digjitale për itineraret dhe asetet prioritare.	2026-2028	Bashkia Patos	Komunikimi vendor, ekspertë	Harta të përdorshme dhe të shpërndara
PRIORITETI 3 – Ruajtja, rehabilitimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i aseteve	Mbrojtja e bazës së produktit turistik përmes mirëmbajtjes, pastrimit dhe ndërhyrjeve të kujdesshme.	2026-2031	Bashkia Patos	Sektorët e mjedisit dhe kulturës	Asete të ruajtura dhe të mirëmbajtura
3.1 Program pastrimi dhe mirëmbajtjeje në asetet prioritare	Organizim i ndërhyrjeve të rregullta për pastrim, eliminim mbetjesh dhe kujdes bazik në pikat e vizitës.	2026-2031	Bashkia Patos	Komuniteti, grupet rinore	Raporte periodike të mirëmbajtjes
3.2 Menaxhim i mbetjeve dhe ndërgjegjësim mjedisor	Vendosje elementësh të thjeshtë për mbetje dhe fushata sensibilizuese për sjelljen në natyrë.	2027-2031	Bashkia Patos	Shkolla, komuniteti	Ulet niveli i ndotjes në asetet kryesore
3.3 Ndërhyrje konservuese të lehta në asete kulturore	Identifikim i nevojave minimale konservuese dhe koordinim me institucionet përgjegjëse.	2027-2030	Bashkia Patos	Institucione kulture, komunitete fetare	Asete të stabilizuara / të mbrojtura
3.4 Monitorim i rregullt i gjendjes së aseteve	Krijim i një praktike të thjeshtë vjetore për vlerësimin e gjendjes së aseteve turistike.	2028-2031	Bashkia Patos	Njësitë administrative	Raport vjetor për gjendjen e aseteve
PRIORITETI 4 – Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe formalizimi i ofertës	Ndërtimi i bazës njerëzore dhe organizative të nevojshme për ofrimin e përvojave turistike.	2026-2031	Bashkia Patos	Institucione trajnuese, OJF, komuniteti	Kapacitete të rritura lokale

4.1 Trajnim i guidave lokale dhe interpretuesve vendorë	Sesione trajnimi për të rinj, mësues, aktorë lokalë dhe persona me interes për të shoqëruar vizitorët.	2026-2029	Bashkia Patos	Shkolla, ekspertë lokalë	Grup i parë guidash lokale të trajnuara
4.2 Trajnime për mikpritjen dhe shërbimin bazë	Trajnime për familje rurale, fermerë, operatorë të vegjël dhe organizatorë eventesh.	2027-2030	Bashkia Patos	OJF, partnerë vendorë	Persona të trajnuar në mikpritje
4.3 Formalizimi i ofertës së mikpritjes dhe aktiviteteve lokale	Mbështetje informuese për regjistrim, standarde minimale dhe prezantim publik të subjekteve.	2027-2031	Bashkia Patos	Biznese lokale	Subjekte të formalizuara dhe të listuara
4.4 Krijimi i rrjetit lokal të aktorëve të turizmit	Takime periodike, forume dhe rrjetëzim ndërmjet njësive administrative, prodhuesve, shkollave dhe aktorëve të tjerë.	2026-2031	Bashkia Patos	Komuniteti lokal	Forume dhe rrjete funksionale bashkëpunimi
PRIORITETI 5 - Marketingu territorial, promovimi digjital dhe partneritetet	Ndërtimi i imazhit të destinacionit dhe i ritmit të komunikimit publik.	2026-2031	Bashkia Patos	Media, partnerë vendorë dhe rajonale	Patos i prezantuar si destinacion lokal
5.1 Krijimi i identitetit vizual të destinacionit	Përzgjedhje mesazhesh, elementësh grafikë dhe narrative të përbashkët për prezantimin e Patosit.	2026-2027	Bashkia Patos	Ekspertë komunikimi, të rinj lokalë	Identitet i përdorshëm në komunikim

5.2 Zhvillimi i pranisë digjitale	Krijim i përmbajtjes për rrjetet sociale, histori të shkurtra, foto, video dhe hartëzim online.	2026-2031	Bashkia Patos	Staf komunikimi, komuniteti	Kanale aktive dhe përmbajtje periodike
5.3 Prodhimi i materialeve promocionale	Broshura, albume fotografike, materiale për evente dhe prezantime publike.	2027-2030	Bashkia Patos	Partnerë vendorë	Materiale të përdorura në promovim
5.4 Krijimi dhe konsolidimi i kalendarit vjetor të eventeve	Përcaktim i eventeve orientuese sipas stinëve dhe njësive administrative; promovim i përvitshëm.	2026-2031	Bashkia Patos	Komuniteti, njësitë administrative	Kalendar vjetor i publikuar dhe i zbatuar
5.5 Partneritete me rrjetet dhe itineraret rajonale	Përfshirje e Patosit në oferta më të gjera të Qarkut Fier dhe bashkëpunim me aktorë rajonalë.	2028-2031	Bashkia Patos	Partnerë rajonalë	Patosi i përfshirë në itinerare ndërvendore
Mekanizmi i ndjekjes së planit të veprimit	Raportim vjetor për ecurinë e masave, vlerësim i ndërmjetëm në vitin 2028 dhe përditësim në fund të periudhës 2031.	2026-2031	Grupi ndërsektorial i turizmit në Bashkinë Patos	Këshilli Bashkiak, partnerët vendorë	Raporte vjetore dhe rishikim i dokumentit

13. ZBATIMI DHE FINANCIMI

Zbatimi i këtij plani kërkon një strukturë të qartë koordinimi brenda Bashkisë Patos, me përgjegjësi të ndara ndërmjet drejtorive që mbulojnë zhvillimin ekonomik, mjedisin, kulturën, shërbimet publike dhe komunikimin institucional. Njësitë administrative kanë rol të drejtpërdrejtë në identifikimin e nevojave, në bashkëpunimin me komunitetin dhe në mbështetjen e ndërhyrjeve në terren. Për këtë arsye, rekomandohet funksionalizimi i një mekanizmi ndërsektorial pune për turizmin, i cili të ndjekë zbatimin e planit, të raportojë mbi progresin dhe të lehtësojë bashkëpunimin me partnerët vendorë dhe rajonalë.

Meqenëse ky dokument është hartuar pa përfshirë kosto orientuese, financimi i masave duhet të trajtohet në kuadër të planifikimit të përgjithshëm financiar dhe projektor të bashkisë, në ndërthurje me programe kombëtare sektoriale, skema mbështetëse për zhvillimin rural dhe bujqësinë, burime nga partnerët zhvillimorë dhe forma bashkëpunimi me sektorin privat. Element kyç për zbatimin e suksesshëm mbetet aftësia institucionale për të përkthyer prioritetet e planit në projekte të qarta, të fazuara dhe të administrueshme.

14. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi i planit do të bazohet në një grup indikatorësh të thjeshtë dhe të matshëm, të lidhur me progresin e ndërhyrjeve dhe efektet në terren. Ndër treguesit kryesorë rekomandohen: numri i aseteve të sinjalizuara dhe të interpretuara; numri i itinerareve funksionale; numri i personave të trajnuar; numri i eventeve të organizuara; numri i subjekteve lokale të përfshira në ofertën turistike; niveli i përmbajtjes dhe angazhimit në kanalet digjitale; si dhe vlerësimi cilësor i vizitueshmërisë dhe kënaqësisë së vizitorëve.

Rekomandohet që Bashkia Patos të hartojë një raport vjetor të progresit të planit, si instrument i brendshëm i menaxhimit dhe si bazë për informimin e Këshillit Bashkiak, partnerëve dhe komunitetit vendor. Një rishikim i ndërmjetëm i zbatimit duhet të kryhet në vitin 2028 për të reflektuar mbi progresin, vështirësitë dhe nevojat për përditësim të masave. Në përfundim të periudhës 2031, plani duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi të plotë, në mënyrë që të shërbejë si bazë për ciklin pasardhës të planifikimit turistik vendor.

15. ANEKSA DHE BURIME

Aseti prioritar	Tipologjia	Përdorimi i rekomanduar turistik
Kalaja e Margëlliçit	Historik/kulturor	Vizitë interpretative, edukim, fotografi, evente simbolike
Rezervuari i Zharrëzës	Natyrore/rekreative	Ecje, piknik, interpretim i peizazhit, evente të vogla
Ujëvarat e Siqecës	Ekoturizëm	Shtigje, natyrë, fotografi, edukim mjedisor
Manastiri i Shën Trifonit	Kulturore/shpirtërore	Itinerar kulturor dhe komunitar
Mekami i Drenies	Shpirtëror/simbolik	Ndalesë në itinerare të turizmit kulturor e komunitar
Ferma/sera/ullishte të përzgjedhura	Agroturizëm	Vizita në ferma, degustime, përvoja gastronomike

Rreziku	Ndikimi i mundshëm	Masa zbutëse
Ndotja dhe degradimi i aseteve natyrore	Ulet cilësia e përvojës turistike dhe dëmtohet baza e produktit	Mirëmbajtje, pastrim periodik, ndërgjegjësim dhe monitorim
Mungesa e koordinimit institucional	Masat mbeten të fragmentuara dhe pa vijueshmëri	Grup ndërsektorial pune dhe raportim periodik
Pjesëmarrje e ulët e komunitetit	Dobësohet përfitimi lokal dhe mungon mikpritja aktive	Forume komunitare, trajnim dhe rrjetëzim lokal
Mungesa e vazhdimësisë në promovim	Destinacioni mbetet pak i njohur dhe pa ritëm komunikimi	Plan i përvitshëm komunikimi dhe përgjegjësi të qarta
Presione mbi identitetin lokal	Rrezik banalizimi ose humbjeje e autenticitetit	Interpretim i kujdesshëm dhe respekt për trashëgiminë

Grupi i punës

Juela Shpata

Mitjon Nikolla

Eneo Xhaferri

Joana Sherifi


Blerina Laçi

Albora Sulaj


Donald Xhafa

MIRATOI
KRYETARI
Fation Duro



Foto të aseteve




Ujëvarat e Siqecës




Mekami “Baba Rrapo”, Drenie




Kisha “Shën Mëhilli”, Dukas




Kisha “Shën Maria”, Sheqishte




Kisha "Shën Sotiri", Sheqishte





Manastiri "Shën Trifoni", Sheqishte







Kisha "Shën Marku", Verbas




Pylli i Belinës



Kalaja e Margëllicit

Error! Bookmark not defined.




Mekami "Baba Mustafai", Ruzhdie



Rezervuari i Ruzhdies



Rezervuari i Zharrëzës



Shtëpitë Autoktone



Rrapi i Zhugrit, Ruzhdie